



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 15 mars 2012  
Nr. ref.: RK207/12

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastet Nr. KI 20/11 dhe KI 96/11**

Parashtrues

**Kushtrim Kqiku**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan P.  
nr. 550/08, të 9 korrikut 2009,**

dhe

**Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan AP. nr. 182/2009, të 29 prillit 2010.**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Kushtrim Kqiku, me vendbanim në Gjilan.

## **Vendimet e kontestuara**

2. Parashtruesi qartazi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan P. nr. 550/08, të 9 korrikut 2009, i cili iu dorëzua më 10 korrik 2009.
3. Përveç kësaj, parashtruesi gjithashtu e përmend në kërkesë edhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan AP. nr. 182/2009, të 29 prillit 2010, i cili iu dorëzua më 26 maj 2010.

## **Objekti i çështjes**

4. Parashtruesi pohon për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

6. Më 18 shkurt 2011, gjyshi i parashtruesit, z. Mahmut Kqiku, parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), në emër të nipit të vet, z. Kushtrim Kqiku, e cila u regjistrua si Rasti Nr. KI 20/11.
7. Më 2 mars 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI20/11, e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KI20/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Iliriana Islami
8. Më 30 qershor 2011, parashtruesi (Kushtrim Kqiku) parashtroi kërkesë në Gjykatë për të njëjtin objekt të çështjes dhe të drejtuar kundër organeve të njëjta publike në Republikën e Kosovës, e cila u regjistrua si Rasti Nr. KI 96/11.
9. Më 1 korrik 2011, Gjykata Kushtetuese e pyeti parashtruesin (Kushtrim Kqiku) nëse e autorizon gjyshin e tij për të parashtruar kërkesë në emër të tij.
10. Më 7 korrik 2011, parashtruesi iu përgjigj kërkesës së Gjykatës duke shtuar që ai e autorizon gjyshin e tij *post festum*, por në të njëjtën kohë kërkoi nga Gjykata që prej atij momenti e tutje çdo formë e komunikimit duhet t'i drejtohet atij, e jo gjyshit të tij Mahmut Kqiku.

11. Më 5 shtator 2011, Gjykata Kushtetuese i njoftoi Gjykatën Komunale në Gjilan, Ministrinë e Drejtësisë (në tekstin e mëtejme: Ministria), dhe Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (në tekstin e mëtejme: EULEX), për parashtrimin e kërkesës.
12. Më 27 tetor 2011, Kryetari, me Vendimin KI 20/11, KI 96/11, urdhëroi bashkimin e këtyre dy kërkesave sipas rregullit 37 (1) të Rregullores së punës pasi ato kanë të bëjnë me të njëjtat çështje ligjore dhe janë të drejtuara kundër organeve të njëjta publike në Republikën e Kosovës. Të njëjtën datë, Gjykata e njoftoi parashtruesin (Kushtrim Kqiku) për bashkimin e kërkesave KI 20/11 dhe KI 96/11.
13. Më 1 dhjetor 2011, parashtruesi e njoftoi Gjykatën Kushtetuese se nuk e kundërshtonte vendimin për bashkimin e kërkesave.
14. Më 24 janar 2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Komunale në Gjilan që t'ia dorëzonte fletëkthesën në të cilën tregohej data në të cilën parashtruesit i ishte dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan AP. nr. 182/2009, i 29 prillit 2010.
15. Më 8 shkurt 2012, Gjykata Komunale në Gjilan iu përgjigj Gjykatës Kushtetuese dhe dorëzoi fletëkthesën në të cilën tregohej data në të cilën parashtruesit i ishte dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan AP. nr. 182/2009, i 29 prillit 2010.
16. Më 7 mars 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

### **Përmbledhje e fakteve**

17. Më 15 nëntor 2007, parashtruesi lidhi kontratë shitblerjeje me një palë të tretë (në tekstin e mëtejme: shitësi) për blerjen e një automjeti.
18. Më 9 prill 2008, parashtruesi ushtroi kallëzim penal në Prokurorinë Publike Komunale në Gjilan kundër shitësit për shkak të mashtrimit.
19. Më 30 maj 2008, Prokurori publik komunal ngriti aktakuzë kundër shitësit në Gjykatën Komunale në Gjilan, me ç'rast pretendohet që shitësi kishte kryer veprë penale të mashtrimit nga neni 261 (1) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK), (PP. nr. 684/2008).
20. Më 11 gusht 2008, parashtruesi parashtri kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjilan për përshpejtim të procedurës (P. nr. 550/08).
21. Më 9 korrik 2009, Gjykata Komunale në Gjilan e shpalli shitësin fajtor për veprë penale të mashtrimit nga neni 261 (1) i KPPK-së dhe vendosi që shitësi detyrohet ta paguajë shumën e cekur në kontratë të shitblerjes (Aktgjykimi P. nr. 550/08). Shitësi ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Gjilan.

22. Më 29 prill 2010, Gjykata e Qarkut në Gjilan e shpalli ankesën e shitësit të pabazuar dhe e miratoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan P. nr. 550/08, të 9 korrikut 2009 (Aktgjykimi AP. nr. 182/09).
23. Më 29 prill 2010, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan P. nr. 550/08, i 9 korrikut 2009, u bë i formës së prerë dhe i detyrueshëm.
24. Sa i përket procedurës përmbarimore lidhur me shumën e cekur në kontratën e shitblerjes dhe në procedurën për ekstradim, faktet janë me sa vijon:

**a) Faktet lidhur me procedurën përmbarimore**

25. Më 4 shkurt 2009, parashtruesi lidhi marrëveshje gjyqësore me shitësin, me ç'rast u pajtuan që shitësi do t'ia paguante parashtruesit shumën e cekur në kontratën e shitblerjes (E. nr. 236/2008).
26. Më 16 mars 2011, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjilan për përshejtim të procedurës përmbarimore lidhur me rastin E. nr. 236/2008, të 4 shkurtit 2009.

**b) Faktet lidhur me ekstradimin**

27. Në ndërkohë, shitësi u largua nga Kosova dhe nuk ishte i arritshëm për përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale dhe të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan.
28. Më 5 mars 2011, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjilan, me ç'rast u propozoi që t'ia bënin një kërkesë zyrtare Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, për ta iniciuar procedurën për transferimin e shitësit në Republikën e Kosovës me qëllim të përmbarimit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan (P. nr. 550/08, të 9 korrikut 2009), i cili u bë i formës së prerë dhe i detyrueshëm me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan (AP. nr. 182/09, të 29 prillit 2010).
29. Më 4 qershor 2011, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Komponentin Policor të EULEX-it në Kosovë, me ç'rast kërkoi iniciimin e procedurës për transferimin e shitësit në Republikën e Kosovës sipas nenit 507 (3) të KPPPK-së.
30. Më 28 qershor 2011, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjilan, me ç'rast kërkoi iniciimin e procedurës për transferimin e shitësit në Republikën e Kosovës sipas nenit 507 (3) të KPPPK-së.

**Pretendimet e parashtruesit**

31. Parashtruesi pretendon që Marrëveshja gjyqësore E. nr. 236/08, sa i përket pjesës substantive, pra kompensimit të palës së dëmtuar, ka stagnuar, edhe pse çështja është aktive që nga 28 marsi 2008.

32. Përveç kësaj, parashtruesi pohon që aktgjykimi i formës së prerë, i 29 prillit 2010, nuk u përmbarua as nga pikëpamja penale as nga pikëpamja civile dhe, si i tillë, mbetet dokument i pavlerë që përbën shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.
33. Nga dokumentet e dorëzuara shihet që parashtruesi kërkon nga Gjykata:
- a. Të konstatojë që ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së;
  - b. T'i obligojë Gjykatën Komunale në Gjilan, Ministrinë e Drejtësisë dhe EULEX-in për iniciimin e procedurave dhe për të bërë përpjekje për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Gjilan, pra për ta ekstraduar shitësin; dhe
  - c. Gjykata Komunale në Gjilan, Ministria e Drejtësisë dhe EULEX-i duhet t'i raportojnë Gjykatës dhe parashtruesit në periudha që Gjykata i sheh të arsyeshme, lidhur me përparimin e arritur në këtë drejtim.

#### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

34. Gjykata vëren që parashtruesi ankohet për tri çështje:
- a. Aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës Komunale në Gjilan P. nr. 550/08, i 9 korrikut 2009, nuk u përmbarua dhe, si i tillë, përbën shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së;
  - b. Marrëveshja gjyqësore E. nr. 236/08, lidhur me kompensimin ndaj parashtruesit, nuk është përmbaruar që nga 28 marsi 2008; dhe
  - c. Organet në Kosovë, pra Gjykata Komunale në Gjilan, Ministria e Drejtësisë dhe EULEX-i, nuk i kanë iniciuar procedurat për ekstradimin e shitësit.
35. Në këtë drejtim, për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
36. Sa i përket Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut AP. nr. 182/2009, të 29 prillit 2010, Gjykata vëren që parashtruesit i ishte dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut AP. nr. 182/2009, i 29 prillit 2010, më 26 maj 2010.
37. Gjykata Kushtetuese gjithashtu vëren që parashtruesi e parashtroi kërkesën më 30 qershor 2011.

38. Në këto rrethana, kërkesa është e parashkruar sipas nenit 49 të Ligjit.

39. Prandaj, rezulton që kërkesa është e papranueshme.

### PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 7 mars 2012, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Ivan Čukalović



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani

